



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 08 dhjetor 2022, në mbledhjen e IX-të (nëntë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 13;25.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; *(Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; dhe Mrika Thaçi)* bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin drejtorët e Drejtorive, dhe atë; *(Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë)*

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera theksoi, siç jeni në dijeni kemi disa ndryshime sa i përket përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa pas dorëheqjes së z.Florent Hasani, z.Haki Rudari është zgjedh anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, gjithashtu pas dorëheqjes së znj.Adelina Stublla anëtare e këtij komiteti është zgjedhur znj.Drita Pajaziti, kjo ishte një informatë. Së pari e konstatojmë kuorumin, kuorumi ekziston, janë 9 anëtar prezent vazhdojmë me punë, paraprakisht materialin e keni marrë me kohë përmes formës elektronike, nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën lidhur me rendin e ditës urdhëroni.

z.Naim Çunaku, theksoi, për këtë rend të ditës i propozoj dy pika shtesë, pika e parë të cilën po e propozoj është kjo, duke u bazuar në rregulloren mbi procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes gjegjësisht duke u thirrur në kapitullin II, nenet 11 dhe 12 me kërkesë të qytetarëve, ndonjë subjekti apo përfaqësuesi të ndonjë subjekti apo përfaqësuesve të mjeteve të informimit mund të bëhet audio incizimi i seancave dhe të bëhet transmetimi i drejtpërdrejtë i tyre andaj kërkoj që si pikë të rendit të ditës Kuvendi të merr vendim për incizimin dhe transmetimin e seancave në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pika e dytë ka të bëjë me subvencionet këtë e them duke marrë parasysh faktin që komuna jonë bënë ndarje të subvencioneve në një masë të caktuar andaj nga ana juaj kërkoj që të formohet një komision ad-hoc për ndarjen e bursave në mënyrë që të bëjë monitorimin se në çfarë forme janë nda bursat dhe a janë ndarë ato subvencione në bazë të rregullativës ligjore. Prandaj propozoj që të formohet një komision ad-hoc për monitorimin e ndarjeve të subvencioneve dhe bursave të vitit kalendarik 2022 dhe ky komision të ketë përbërjen prej 3 anëtar prej tyre 2 anëtar të jenë nga radhët e opozitës, nëse ky komision ka përbërjeje prej 5 anëtarëve atëherë shumica e anëtarëve të këtij komisioni të jenë nga radhët e opozitës.

z.Haki Rudari, theksoi, realisht i dëgjova dy propozimet e kolegut z.Naim Çunaku, mendoj që propozimi i parë sa i përket audio incizimit të seancave dhe transmetimit të drejtpërdrejtë tanimë Komuna i ka blerë pajisjet prandaj nuk ka nevojë që ne të votojmë një gjë të tillë kurse sa i përket propozimit të dytë është miratuar një rregullore në Kuvend dhe në bazë të kësaj rregulloreje bëhet ndarja e subvencioneve për kategori të ndryshme andaj mendoj se është e pa arsyeshme të formohet një komision kur ekziston rregullorja për kushtet dhe kriteret e ndarjes së subvencioneve. Megjithatë e drejtë e secilit është të bëjë propozime dhe ato të vihen në votim por ne do të votojmë kundër këtyre propozimeve ngase mendojmë se janë të pa arsyeshme.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur që të kuptohet si polemikë por më tepër kisha dashur që të jetë si sqarim se një prej kriterëve të kësaj qeverisje të mirë është llogaridhënia dhe transparenca komunale dhe nuk e di se ku do ishte problemi sepse së fundmi është në dorën e secilit dhe e drejtë ekskluzive mirëpo të pretendosh për një qeverisje të mirë demokratike, llogaridhënese dhe e hapur për qytetarin e mos të përkrahësh propozimin tim që seancat e Kuvendit Komunal të transmetohen në formë të drejtpërdrejtë po më duket në kundërshtim me vetë format e qeverisjes demokratike.

Ndërsa atë që e ceku kolegu z.Haki Rudari që komuna i ka pajisjet, komuna i ka pajisjet për nevojat e saj dhe me vetë faktin ata që e bëjnë incizimin e mbledhjeve të kuvendit në një formë e kanë në dorë mbarëvajtjen e atij incizimi dhe nuk është e besueshme sikurse të ishte një medium, cili do qoftë ai i cilit do vend që do të transmetonte drejtpërdrejt mbledhjet e kuvendit para qytetarëve në mënyrë që qytetarët të kenë mundësi ta shikojnë drejtpërdrejtë secilin përfaqësues që e ka marrë besimin qytetarë se si vepron dhe për çka angazhohet dhe nuk e di se ka diçka më frytdhënese dhe nëse bëhen punë të mira dihet në adresë të kujt bëhen po ashtu edhe nëse bëhen punë të këqija dihet prapë adresa e kujt është dhe nuk e di pse kemi diçka për të fshehur nga qytetari, këtë e kuptoj si mbështetje të qeverisjes nga qytetari, gjegjësisht të Kuvendit Komunal.

Sa i përket propozimit të dytë për hartimin e një komisioni ad-hoc, unë jam i vetëdijshëm se ato rregullore kanë kaluar përmes Kuvendit dhe janë pjesë përbërëse të Kuvendit mirëpo Kuvendi me miratimin e rregullores ka përfunduar punën e tij. Kur kolegu z.Haki Rudari thotë këtë e kur e di se vet ka kërkuar që anëtar të komisionit të ketë nga asambleja për ndarjen e bursave dhe subvencioneve dhe tani të jetë kundër kësaj nuk e di se çka ka për tu fshehur aty edhe nëse është gjithçka në rregull nuk e di pse duhet të hezitoj në atë send, mirëpo këtu kemi një paragjykim që nuk është gjithçka transparente këtu, unë dua ta di se a ju keni përmbajt asaj rregulloreje ose jo dhe nëse ju keni përmbajt rregullores për ndarje të subvencioneve nuk e di pse nuk duhet të formohet komisioni por nëse nuk ju keni përmbajtur rregullores prapë ajo nuk mund të fshihet se ka forma tjera ku ato bëhen publike për lëshimet eventuale që kanë ndodh, po paragjykoj.

z.Haki Rudari, theksoi, ajo që e kam thënë unë në vitet 2013-2017 ka qenë legjitime për arsye se atëherë ka qenë një ndarje ad-hoc, tani janë miratuar rregulloret në Kuvendin Komunal dhe gjithçka është transparente, nuk e di z.Naim Çunaku se çka duhet të jetë transparencë më e madhe se sa kur të publikohet lista e atyre subvencioneve që janë nda në bazë të rregullores për ndarje të subvencioneve. Ndarja e subvencioneve nuk bëhet për teke të askujt por në bazë të rregullores për kategoritë e caktuara, nëse ju keni vërejtur ndonjë shkelje të rregullores është Kuvendi dhe këtë çështje mund ta ngrisni në pikën të ndryshme andaj unë mendoj se është plotësisht e pa arsyeshme të hyjnë këto pika në rend të ditës ngase kemi vetëm kthim mbrapa. Sa i përket transparencës komunale askush nuk ju pengon që t'i përcillni punimet e Kuvendit në cilin do televizion që ju përshtatet, ne se kemi këtë problem, Kuvendi i ka mjetet e tij të cilat i përcjellë prandaj mendoj se është plotësisht e pa arsyeshme të futet ky propozim i juaj si pikë e rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur ta zgjasë debatin por të thirresh sot se kemi një rregullore kurse atëherë kemi bë komisione ad-hoc se nuk kemi pas rregullore për ndarje të subvencioneve është më tepër se etike edhe atëherë edhe tani nuk mund të ndahet asnjë subvencion apo një bursë pa rregullore edhe atëherë kanë qenë disa rregullore në fuqi për ndarje të subvencioneve mirëpo dikur dikush i ka parë jo të besueshme kurse sot që kanë ndërruar rolet, kam të drejtë unë t'i shohë ashtu dhe kjo po më duket më tepër se politikë për mos me thënë diçka tjetër dhe është shumë normale se për këtë vendos shumica kur kjo vihet në votim. Mirëpo të pretendosh se atëherë janë nda keq subvencionet kurse tani po ndahen mirë e pasi që po ndahen subvencionet mirë s'dua t'i shohë ata që po bëjnë një punë e mirë kjo vetvetiu po tregon që ndarja e subvencioneve s'është bërë mirë. Sa i përket sallës së Kuvendit gjegjësisht mbledhjeve dhe komisioneve të Kuvendit, të Komiteteve dhe të çdo organi që e ngritë Kuvendi e dimë që në rregullore është e paraparë që kemi të drejtë të marrin pjesë në punime të Kuvendit por të bëhemi pak më të sigurtë e të tregojmë se a kemi kushte ne për publikun, nuk kemi kushte për publikun, edhe po t'i kishim kushtet për publikun nuk do të thotë që kur është hartuar kjo rregullorja që e lexova unë e nuk e di se në vitin 2011 a keni qenë ju anëtar i Kuvendit, Kuvendi e ka miratuar këtë rregullore që do të thotë se nuk është marrë prej rrugës kjo edhe atëherë është paraparë nevoja që të ketë transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit. Kjo që po tentoni me bë, thirre kë të doni, bëni çfarë të doni, leni këto se unë këtu nuk jam vetvetja por përfaqësoj dikë.

z.Haki Rudari, theksoi, unë thash secili medium ka të drejtë të marr pjesë në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar askush nuk e kontestoj këtë dhe çfarë teme është kjo sepse ju nuk mund t'ia ndaloni punën mediumit apo t'i tregoni se çka të bëjnë dhe unë nuk kam punë me medime këtu por po e paraqes një kërkesë që seancat e Kuvendit Komunal ashtu siç e parashih rregullorja të jenë të incizuara dhe të transmetohen drejtpërdrejtë ky ishte propozimi im ju mund të votoni kundër, mundeni me thënë se tani ne jemi në pushtet dhe nuk ka më transparencë dhe llogaridhënie dhe nuk mund të shohë qytetari se çka bëjë unë, kjo është punë e juaj, ju votoni kundër, unë votoj për dhe jemi në rregull.

z.Qendrim Softolli, theksoi, dua të ndërlihem me propozimet e kolegut z.Naim Çunaku, sa i përket transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit nuk e di pse ka nevojë që të politizohet kaq shumë ky propozim, mendoj se e meritojnë edhe qytetarët me pas një qasje dhe një transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit, këtë mendim e kam edhe për anëtarët e Kuvendit. Sa i përket ngritjes së komisionit ad-hoc për monitorimin e ndarjes së bursave dhe subvencioneve ne kemi shumë arsye për këtë, sa i përket transparencës e kemi parë vitin e kaluar se çfarë skandalesh janë prodhuar te ndarja e bursave dhe nëse është aq transparencë atëherë pse të hezitohet, nëse jeni në rregull nuk keni arsye pse ta mohoni këtë propozim, le të krijohet komisioni, nëse më lejoni të them të hetohen ato procedurat e ndarjes së bursave dhe nëse del se gjitha procedurat kanë qenë në rregull atëherë përmbillet edhe kjo temë dhe nuk ka asgjë të keqe.

z.Bashkim Sylja, theksoi, unë mendoj që së shpejti do të vendosen kamerat në sallën e Kuvendit sepse të gjitha pajisjet janë ble kështu që ideja për lidhjen e kontratës me ndonjë televizion nuk e di sa është e arsyeshme, askush televizioneve apo medimeve të ndryshme nuk ua ndalon përcjelljen e seancave të Kuvendit, për këtë çështje ne mund të kërkojmë mendim edhe nga ekzekutivi por unë mendoj se në Ueb Faqen e Komunë seancat e Kuvendit transmetohen drejtpërdrejtë. Sa i përket komisionit për monitorimin e ndarjes së bursave, ne e kemi miratuar një rregullore për ndarje të subvencioneve dhe në atë rregullore janë të parapara kriteret. Është e vërtetë se në të kaluarën në ndarjen e bursave kanë bërë shkelje së paku ne nga jashtë kështu kemi menduar, tash ky komisioni sa ka fuqinë dhe mandatin për monitorimin e bursave unë nuk e di por sa i përket lidhjes së kontratës me ndonjë medium për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të Kuvendit unë jam kundër kurse sa i përket rregullores për ndarje të subvencioneve për këtë unë s'kam mendim sepse në të kaluarën ka pas fjalë që ka pasur

manipulime në ndarjen e bursave andaj abstenoj në këtë propozimin e dytë kurse për propozimin e parë jam kundër. Dua të jem shumë transparent ky është mendimi im.

z.Qendrim Softolli, theksoi, fjala këtu është vetëm për transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, Komuna tani ka bërë instalimin e ri të kamerave dhe tani e tutje në Ueb Faqen e Komunës do të bëhet transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të Kuvendit, ndoshta mund të gaboj por kështu mua më ka informuar andaj çdo televizion mund ta merr atë transmetim të drejtpërdrejtë dhe ta transmetoj, kurse sa i përket këtyre dy propozimeve ne mund t'i vejmë në votim që të kalojnë ose jo si pika të rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, vetëm edhe një sqarim i nderuari Kryesues, propozimin nuk e bëra përmendësh por duke u bazuar në rregullore të Kuvendit, nëse ne sot jemi kundër saj jemi kundër një rregulloreje të punës së Kuvendit dhe me vetëdije të plotë po bëhemi shkelës të saj.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, TV Llapi ka pas një kontratë me Komunën e Podujevës për transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Kuvendit, ajo kontratë ka skaduar tash pse nuk është bërë vazhdimi i saj unë nuk e di.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave- DBF, theksoi, sa i përket transmetimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve të kuvendit, Komuna e Podujevës e ka zhvilluar një procedurë të prokurimit ku është nënshkruar kontrata e cila tani është në fazën e realizimit për instalimin e pajisjeve për transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave, ku transmetimi i drejtpërdrejtë i këtyre seancave bëhet në faqen e facebookut të Komunës së Podujevës si dhe në Ueb faqen e Komunës së Podujevës dhe nga ajo faqe cilido televizion medium apo cila do faqe tjetër private mund ta merr atë transmetim të drejtpërdrejtë dhe ta transmetoj. Ne dimë që më shumë shikime ka në faqen e facebookut këtë e shohim në faqet e ndryshme të televizioneve se normalisht në televizione qendrore nuk bëhet transmetimi i seancave kjo ishte vetëm sa për informim se ndoshta unë si drejtor i DBF-së nuk e kam këtë detyrë mirëpo ky ishte vetëm një sqarim. Të them me një fjalë sa i përket transmetimit të drejtpërdrejtë të seancave kjo është punë e kryer.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, z.Naim Çunaku i bëri dy propozime mirëpo edhe unë i kam dy propozime sepse nga ana e Ministrive përkatëse janë kthyer dy vendime të mbledhjes së fundit të Kuvendit për rishqyrtim e këto vlerësime kanë të bëjnë me propozim rregulloren për taksa tarifa dhe gjoba komunale që është kthyer në rishqyrtim në Kuvend, arsyetimin e kemi nga niveli qendror të cilin po e lexoj para jush. Në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës është miratuar rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale e cila i ka kaluar të gjitha procedurat dhe fazat e parapara ligjore mandej sa jemi në dijeni ka pas edhe shqyrtim paraprak të këtij dokumenti me kërkesën e drejtorit të DBF-së. Në procesin e shqyrtimit administrativ të kësaj rregulloreje sa për sqarim MAPL-ja, e ka përcjellë këtë rregullore nëpër të gjitha ministritë e linjës për të dhënë vlerësimin e tyre të ligjshmërisë ku disa prej tyre kanë vlerësuar se rregullorja në fjalë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, disa prej tyre kanë kërkuar harmonizim të ndonjë takse, tarife komunale dhe të ngjashme. Në këtë aspekt sipas dispozitave ligjore rregullorja duhet të shqyrtohet brenda 30 ditëve nga pranimi i vlerësimit të ligjshmërisë ose të harmonizohet me rekomandimet e ministrive ose si e tillë të anulohen dhe kërkohet nga ekzekutivi që në një afat optimal të përgatitet drafti i ri duke i përshtatur me rekomandimet e ministrive dhe të konsultohen ministritë përkatëse dhe të silltet për shqyrtim final në Kuvend.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, ne jemi të informuar se rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale e cila është në fuqi është parë e arsyeshme që të bëhen disa ndryshime, asambleja komunale ka votuar draft rregulloren për të cilën pas votimit unë kam kërkuar një vlerësim paraprak të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Financave për këtë e kam vlerësimin e ligjshmërisë së Ministrisë së Financave si pozitive me një vërejtje të cilën kur ka shkuar si

draft final për votim është përmirësuar ajo vërejtje e Ministrisë së Financave dhe faktikisht kemi vlerësim paraprak të ligjshmërisë të Ministrisë së Financave. Draft rregullorja kur është votuar në asamblenë komunale në mbledhjen e fundit ka shkuar në vlerësim të ligjshmërisë në MAPL, pastaj ky vlerësim nga MAPL-ja i është përcjellë ministrive të linjës për vlerësim ligjor, disa ministri i kanë disa vërejtje specifike, t'ju them të drejtën me shumë vërejtje të ministrive nuk pajtohemi edhe pse kemi marrë një vlerësim paraprak ligjor, ne si institucion kemi mundësi që këtë vlerësim ta dërgojmë në gjykatë për konflikt administrativ se nuk është e thënë me iu përmbajte vendimit të cilin e merr x zyrtari në Ministrinë e Arsimit. Meqenëse jemi në fund të vitit ne propozojmë që kjo rregullore e cila është votuar të anulohet dhe të fillojnë procedurat e përmirësimit të saj, arsyeja pse duhet të anulohet kjo rregullore dhe të rikthehet prapë në Kuvend përkundër asaj që vendimin nuk e konsideroj të drejtë nga x ministrinë, për mos ta elaboruar më shumë kjo është edhe si kriter për grandin e performancës për ne nëse kemi sukses ta fitojmë atë. Njëri nga kriteret është që çdo vendim që kthehet nga Ministria përkatëse të rikthehet për shqyrtim në Kuvend që faktikisht nuk i imponohet Kuvendit sepse këtë nuk mund t'ia imponoj x Ministria, mirëpo ne duhet ta rikthejmë këtë rregullore në Kuvend dhe ta anulojmë nëse nuk anulohet kjo rregullore bie dilema se ne a duhet të veprojmë sipas saj apo sipas rregullores së vjetër. Propozimi jonë është që të anulohet kjo rregullore që është votuar dhe të bëhen përmirësimet në bashkëpunim me ministrinë e linjave për përmirësimet përkatëse pastaj e njëjta rregullore të vihet edhe njëherë në votim.

z.Naim Çunaku, theksoi, nëse një organ më i lartë i ka gjet të metat e kësaj rregulloreje dhe ka gjet shkelje ligjore normalisht kjo rregullore duhet të anulohet, nëse ne e kemi rregulloren tjetër që e zëvendësojmë në pikat kontestuese atëherë është ripërpunim i saj mirëpo rregullorja e miratuar në Kuvend taksativisht forma që është miratuar i është kontestuar ligjshmëria nga organi mbikëqyrës dhe ne duhet ta kthejmë këtë në kufij të ligjshmërisë. Ne s'kemi marrë pjesë si grup në hartimin e rregullores për taksa tarifa dhe gjopa komunale dhe për këtë kam një vërejtje sepse në këtë rregullore ekziston një dispozitë e cila në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës është e ndaluar apo e pezulluar tarifa për lojërat e fatit. Derisa një gjë e tillë është e ndaluar me ligj dhe nuk funksionon në Republikën e Kosovës dhe ne parashohim tarifa.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës fatkeqësisht një gjë e tillë nuk është e ndaluar sepse kisha dashur shumë që lojërat e fatit të ishin të ndaluara, por lojërat e fatit janë pezulluar si veprimtari, pasi që janë pezulluar ne duhet ta kemi atë dispozitë ligjore në rregullore të gatshme dhe me qëllim ne e kemi rritë këtë tarifë që të destimulojmë këtë aktivitet.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ju njoftoj se kemi edhe një pikë tjetër për rishqyrtim sepse ne e dimë se në mbledhjen e fundit të Kuvendit është marrë një vendim për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës me këtë përbërje, z.Ardi Hasani, nga radhët e subjektit politik LVV, znj.Drita Pajaziti nga radhët e subjektit politik LVV, znj.Mimoza Abdullahu nga radhët e subjektit politik PDK, z.Burim Hasani nga radhët e subjektit politik AAK, nga radhët e ekzekutivit znj.Antoneta Ejupi - drejtoreshë e Drejtorisë së Administratë, znj.Bleona Rama nga radhët e Shoqërisë Civile.

Ky komision është formuar në mbledhjen e fundit mirëpo në procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë MAPL ka vlerësuar se përbërja e këtij komisioni është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi me arsyetim duke cituar nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 5.2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019, për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, i cili thekson se komisioni duhet t'i ketë 7 anëtar prej tyre 4 anëtar duhet të jenë nga radhët e Kuvendit të Komunës nga subjekte të ndryshme politike, 1 anëtarë nga radhët e ekzekutivit, 1 anëtar nga shoqëria civile dhe 1 përfaqësues nga fshati vendbanimi apo lagja urbane ku

mbahet takimi. Ne kështu kemi vepruar dhe kemi zgjedhur 4 anëtar nga radhët e Kuvendit mirëpo ne në Kuvend i kemi të përfaqësuar 5 subjekte politike, në qoftë se ky komision do të përbëhet prej 5 anëtarëve atëherë ne do t'i përfshinim gjitha subjektet politike. Siç dihet në mbledhjen e fundit grupi i këshilltarëve të LDK-së nuk ka marrë pjesë, s'ka qenë prezent dhe nuk kemi mundur të japim propozime pasi që nuk kanë qenë prezent përbërjen e komisionit nuk kemi mundur ta lëmë të zbrazët sepse është zgjedhur një komision që është dashur të votohet në Kuvend. Si do që të jetë si Kuvend jemi të detyruar që vendimin në fjalë ta rishqyrtojmë sipas vlerësimit të ligjshmërisë të MAPL-së, përkatësisht në kuadër të komisionit në fjalë të përfshihet edhe një përfaqësues i subjekteve politike që nuk është i përfshirë. Këtu tani kemi edhe një dilemë sepse ne kemi në Kuvend dy subjekte politike që nuk janë të përfshira në këtë komision, tani edhe kjo pikë duhet të hyjë në rend të ditës për rishqyrtim.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari z.Kryesues me keqardhje e them por tentimi i barazimit dhe konstatimit disa herë se prej sa subjekteve politike përbëhet ky Kuvend me të vërtetë është jo serioze dhe me të vërtetë nuk kisha mundur ta përsërisë këtë siç e përsëritët ju. Të tentosh ta barazosh një subjekt me një anëtar të përfaqësuar në Kuvend me një subjekt që përfaqësohet prej 14 anëtarëve në këtë Kuvend s'di çfarë fjale ta përdor sepse është më tepër se hipokrizi. Më ka rastësisë të dëgjoj prononcimin e juaj në një televizion z. Kryesues dhe të shefit të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, dhe sigurisht ju e dini se çka keni thënë por kolegët nuk e di a e dinë se keni thënë që LDK-ja e ka përjashtuar vetën dhe e thoni për subjektin më të madh politik në Kuvend e kemi të rezervuar përbërjen e anëtarëve të KPF-së me 3 anëtar kurse në Komitetin për Komunitete me 2 anëtar, publikisht e thoni një të pa vërtetë sepse LDK-ja e ka të përfaqësuar vetëm një anëtar në Komitetin për Komunitete.

Si pikë referente po e marrim të kaluarën e Kuvendit kur s'ka pas gatishmëri subjekti të propozoj kandidatin e tij gjithëherë vendi i tij ka mbetur i zbrazët për tu plotësuar më vonë kur ata kanë shprehë gatishmërinë po nëse nuk kanë gatishmëri ai vend i kandidatit nuk plotësohet sepse LDK-ja mund të mos marrë pjesë kurrë edhe pse e ka kandidatin e saj.

Për të ndarë diçka këtu dhe me pa sherr, një sherr i ulët te komisioni për hartimin e planit të punës së Kuvendit ju keni lënë vend zbrazët ndërsa për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane nuk ka pas vend, po e përmbylli z. Kryesues se po të ishte ashtu siç e arsyetoni ju sigurisht se nuk do ta merrje një kundërshtim prej një instance më të lartë. (Kështu e keni pas bërë edhe njëfarë lame rreth asaj që duhet me i ra deficit, ruaju këtyre sendeve Kryesues se jemi këtu si Kuvend Komunal.)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne këtë pikë e kemi kthyer në rishqyrtim dhe nuk kemi pse të debatojmë më shumë sepse për këtë pikë do të debatojmë në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju tani po thoni se i kemi pas 5 anëtarë dhe tani na kanë dal telashe por s'mundeni se kjo është e përcaktuar edhe në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale ku thuhet se fuqia politike e Komisioneve ndërtohet në bazë të fuqisë së votave që e kanë në Kuvend dhe të pretendosh ta barazosh një grupim politik me gjithë respektin për të që përbëhet prej një anëtari me një subjekt që i ka 14 anëtar të përfaqësuar në Kuvend është përtej normales kjo i nderuari Kryesues.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju ka për të shtuar diçka urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim propozimin e z.Naim Çunaku, që të hyjë si pikë e rendit të ditës propozimi që seancat e Kuvendit Komunal ashtu siç e parasheh rregullorja të jenë të incizuara dhe të transmetohen drejtpërdrejtë.

Pas votimit Kryesuesi konstaton se me 3 vota për(Naim Çunaku, Qendrim Softolli, Arnisa Sylejmai), 4 vota kundër (Haki Rudari Drita Pajaziti, Sebastina Vokrri, Bashkim Sylja) 2 vota të përmbajtur (Hilmi Hoxha, Mrika Thaçi), nuk kalon propozimi i z.Naim Çunaku që seancat e Kuvendit Komunal ashtu siç e parasheh rregullorja të jetë të incizuara dhe të transmetohen drejtpërdrejt.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e vë në votim propozimin e dytë të z.Naim Çunaku që të formohet një komision ad-hoc për monitorimin e ndarjeve të subvencioneve dhe bursave të vitit kalendarik 2022.

Pas votimit Kryesuesi konstaton se me 3 vota për, (Naim Çunaku, Qendrim Softolli, Arnisa Sylejmai), 4 vota kundër, (Hilmi Hoxha, Haki Rudari Drita Pajaziti, Sebastina Vokrri) 2 të përmbajtura, (Bashkim Sylja, Mrika Thaçi) nuk kalon propozimi i z.Naim Çunaku që të formohet një komision ad-hoc për monitorimin e ndarjeve të subvencioneve dhe bursave të vitit kalendarik 2022.

z.Naim Çunaku kërkon që në procesverbal të ceken me emra anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa për secilën votë për secilin propozim apo pikë të rendit të ditës dhe të dihet vota e secilit se si votoj.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e vë në votim propozimin për Rishqyrtimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoha Komunale që të hyjë si pikë në kuadër të rendit të ditës.

Pas votimit Kryesuesi konstaton se me 5 vota për, asnjë votë kundër, 4 vota të përmbajtura kalon propozimi për Rishqyrtimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoha Komunale.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e vë në votim propozimin për Rishqyrtimin e Vendimit për formimin e komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës.

Pas votimit Kryesuesi konstaton se me 6 vota për, asnjë votë kundër, 3 vota të përmbajtur kalon propozimi për Rishqyrtimin e Vendimit për formimin e komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Naim Çunaku, theksoi, rishqyrtimi ligjor është obligim dhe ne nuk kemi nevojë të votojmë.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, i nderuari z.Naim Çunaku kjo pikë e rendit të ditës duhet të kalojë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa për rishqyrtim në Kuvend.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është mirë që Ministrinë përkatëse janë organe mbikëqyrëse dhe secilin akt të Komunave që është në kundërshtim të ligjshmërisë e rikthejnë rishqyrtim se kohë më parë ju keni pas çështje politike të cilat i keni zgjedh.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari z.Bashkim Sylja është mirë kur te përdorni fjalën ne, ju, ata, të dihet për kënd bëhet fjalë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, fjalën e kisha për LDK-në.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju dëgjova me vëmendje tani po e them se kur janë ndarë bursat ne kemi pas dyshime se s'janë në rregull, pse kemi pas dyshime, pse kemi qenë në opozitë dhe kemi pas të drejtë mirëpo edhe tani kur ne po themi se ka parregullsi në ndarjen e bursave ju po thoni keni pas dyshime por në të njëjtën kohë ne kemi të drejtë të kemi dyshime në punën e juaj.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, pa humbur kohë më shumë tani e vë në votim rendin e ditës, përfshirë këtu edhe propozimet të cilat kaluan më parë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit/KPF-së konstaton se nga 9 anëtar sa ishin prezent në mbledhje me 5 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet rendi i ditës.

Rendi i miratuar i ditës

- *Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës*
- *Propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës*
- *Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023*
- *Rishqyrtimi i Rregullores për taksa tarifa dhe gjopa Komunal*
- *Rishqyrtimi i Vendimit për formimin e komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës*

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28 tetor 2022

Pa vërejtje apo ndryshim plotësime, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28 tetor 2022, sipas materialit përkatës të dërguar.

2. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, DPZHE, theksoi, para jush keni një dokument, përkatësisht strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal për vitin 2023-2025, dokument i cili i ka kaluar gjitha procedurat sipas udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi. Është mbajtur debati publik më datë 13.10.2022, po ashtu prej datës 05.10.2022 deri më datë 05.11.2022, ka zgjatur dëgjimi publik, gjitha plotësim ndryshimet janë bërë brenda këtyre afateve dhe tani nga ana e juaj kërkoj mbështetje që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë për shqyrtim në mbledhjen e radhë së Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, për draft strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal 2023-2025, dihet se është njëri nga dokumentet më të rëndësishme që i jep orientim zhvillimit të Komunës dhe pas përfundimit të draft strategjisë që ka qenë deri më tani sigurisht se një draft strategji e punuar në formën që e sheh gjendjen se ku do të jetë Podujeva në vitin 2025, duke pas para sysh atë që e ceku drejtori që ky dokument i ka kaluar të gjitha anët formale dhe procedurale dhe ka ardhë deri këtu dhe kur kemi çështje të cilat duhet të debatohen se a duhet të shtohet apo të largohet diçka nga ky dokument sa i përket kësaj pjesës ku është përshkruar gjendja aktuale dhe ku jemi ka defekte teknike mos të them edhe përmbajtësore, këtë e them sepse është bërë ndarja administrative e Komunës ashtu siç ka qenë para luftës së fundit në Kosovë para vitit 2000 dhe ashtu është pasqyruar, njësoj edhe te furnizimi me ujë është pasqyruar.

Nuk e di këto përmirësime a mund t'i bëjmë sot ose nesër në mbledhjen e Kuvendit taktativisht do t'i numëroj me qëllim që të kemi një dokument sa më të mirë sa më përmbajtësor, sa me më pak defekte se një dokument voluminoz i kësaj natyre siç është ky, është e mundshme që mund të përvidhet ndonjë gabim teknik ta them, kurse sa i përket pjesës së dytë apo vizionit se ku do të jetë Podujeva në vitin 2025, kur e lexova më të vërtetë po mundohem mos të them diçka nga vetvetja por me të vërtetë i kam shkruar dy fjali në fund të saj dhe nëse arrijnë këto objektiva të cilat janë të numëruara këtu t'i realizojmë në vitin 2025 me të vërtetë jam njëri prej njerëzve që ka me e qenë i kënaqur me këtë kosto financiare që e keni parapa prej 47,000,000.00€, të realizohen gjithë këto projekte në vitin 2025, kisha dashur dhe kisha aluduar të ndodh ashtu dhe do të isha njeriu më i lumtur në Komunën e Podujevës, për mos me thënë se do të jemi komuna më e suksesshme në nivel vendi dhe më nuk do të ketë telashe për t'i fituar zgjedhjet tjera

z.Haki Rudari që po qeshesh.

z.Haki Rudari, theksoi, këtë po e shkruaj diku.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, unë dhe z.Haki Rudari njihemi mes veti dhe gjërave të mira unë i them se janë të mira por gjërave tjera nuk mund t'i them dhe dyshoj në realizimin e kësaj strategjie mirëpo uroj që të realizohet.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, ta them me një fjalë do të thotë se jeni i kënaqur me strategjinë.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk desha të jem kritikues se kur të kesh diçka apo të parashikosh diçka duhet të kesh mendim pozitiv për të arritur qëllime të mira dhe në këtë kontekst desha ta kem orientimin e diskutimit mirëpo unë dyshoj se kjo strategji është një fontanë dëshirash, kur të përfundoj viti 2025, ne këtu do të jemi prandaj i uroj vetës dhe të gjithëve shëndet dhe do të debatojmë për këtë temë mirëpo kisha dashur së paku 50% e kësaj strategjie të jetë e realizuar sepse nuk do të jetë realizueshmëria e kësaj strategjie as 50% mbajeni në mend fjalën time.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ashtu siç e sqaroi pjesën e parë të strategjisë z.Naim Çunaku, është e njëjtë me strategjitë e kaluara përveç disa shifrave që ndryshojnë dhe që merren nga statistikat në nivel kombëtar dhe inkorporohen në këtë strategji. Unë kam disa vërejtje të vogla por ashtu siç theksoi kolegu z.Naim Çunaku ajo që është paraqitur në strategji uroj që të realizohet se përnjëmend është një plan voluminoz ku në të shumtën e projekteve të mëdha është e përfshirë edhe qeveria, tani të bëhemi realistë ne i kemi pas marrë disa vendime për caktimin e lokacionit për ndërtimin e disa çerdheve mirëpo ndërtimi i tyre nuk ka filluar ende. Tani këto projekte janë bartë për vitin 2023, me një kosto të rritur se a përfundojnë ose jo këto projekte në vitin 2023 mbetet për tu parë. Kam edhe disa vërejtje të vogla p.sh, një rubrikë të pjesa e dytë e këtij dokumenti sa i përket identifikimit të investitorëve të huaj sipas veprimtarisë dhe numrit të punëtorëve ku janë të parapara 2000.00€, për 3 vite e kjo duket qesharake mirëpo ka kohë që të përmirësohet kjo. Sa i përket ndërtimit të një çerdheje në fshatin Kërpimeh dhe dy çerdheve në qytet janë marrë vendimet për ndërtimin e tyre por të them me dorë në zemër se ne me pushtetin jemi marrë vesh që ndërtimi i çerdhes së tretë të bëhet në fshatin Gllamnik, mirëpo nuk e kanë mbajtur premtimin e dhënë tash duhet të shohim se çka mund të bëjmë në të ardhmen se a do të ketë mundësi të bëhet ndarje buxhetore për këtë çështje, kjo që e thash është e vërtetë dhe këtë drejtori e din. Sa i përket rekrutimit të shërbimit civil për çdo shkollë janë nda nga 32,000.00€, nëse e llogarisim koston për çdo shkollë këtë shumë 32,000.00€, 3 psikologë brenda 3 viteve është kostoja e këtyre mjeteve. Sa i përket përmirësimit të kushteve të banimit për 250 familje janë ndarë 130,000.00€ që i bie se janë ndarë 520€ për familje dhe me këto mjete të ndara nëse mund të rregullosh kushte të brendshme brenda një familje unë do isha shumë i kënaqur por një gjë e tillë është e pa mundur, këto janë vërejtjet e mia dhe kisha pas dëshirë që t'i merrni parasysh jo pse po i them unë por thjesht që të del strategjia sa më mirë sa më funksionale. Disa projekte që do të realizohen në bashkëfinancim me qeverinë janë në shuma më të mëdha shpresojmë të realizohen se janë në interes për komunën tonë mirëpo si strategji e zhvillimit ekonomik të Podujevës, me projekte të Prishtinës mbetet për tu parë, thjeshtë nuk po flas politikisht se interes i yni është që Komuna dhe qyteti të zhvillohen sa më shumë.

z.Qendrim Softolli, theksoi, me qeverisjen qendrore aktuale besoj se Komuna jonë ka me ia arrit, me koncentrimin dhe fondet e saj besoj që kjo strategji do të jetë funksionale.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, nuk e di se ku janë ato koncentrime.

z.Qendrim Softolli, theksoi, gjithkund vetëm në Podujevë jo, fjala është për grandet qeveritare që mungojnë për Komunën e Podujevës.

z.Haki Rudari, theksoi, unë mendoj se draft strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2023-2025, është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm për mirëqenien e qytetarëve më vjen mirë që edhe kolegu nga LDK-ja e pranoj që është një dokument që do të realizohet me sukses dhe e evidentova, ky dokument

është voluminoz shpresoj ta keni lexuar, kemi investime në çdo sektor, pra kemi realisht objektiva shumë të rëndësishme të cilat me të vërtetë janë shumë të rëndësishme për qytetarët tanë.

Në këtë strategji kemi projekte të detajuara për vitet 2023-2025, dhe po ashtu jo vetëm tani por çdo herë niveli qendror i ka ndihmuar komunat me investime dhe në këtë drejtim është një element pozitiv për arsye se qeveria nuk ndan mjete për anëtarët e LVV-së por ndan mjete për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës dhe mendoj se këtij investimi i nderuari koleg nga radhët e LDK-së, është mirë që t'i gëzoheni sepse i kemi rreth 30,000,000.00€, të ndara nga qeveria jo për LVV-në, por për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe ju duhet të gëzoheni për këtë investim. Natyrisht se ne asnjëherë nuk themi se këto mjete të ndara nga qeveria mjaftojnë, nëse qeveria ndan edhe 50,000,000.00€, ne themi se nuk mjaftojnë edhe 60,000,000.00€, por ne duhet ta përkrahim këtë investim pasi që është investim që është në të mirë të qytetarëve. Unë e falënderoj drejtorin e DPZHE-së për këtë strategji se realisht është shumë transparente dhe e detajuar, unë e kam strategjinë e kaluar dhe nëse e krahasojmë me këtë me të vërtetë është një dallim.

z.Naim Çunaku, theksoi, po nisem prej fjalës së fundit që e ceku kolegu z.Haki Rudari, kjo strategji dallon prej strategjive tjera, vërtetë dallon se atëherë e kemi bërë strategjinë para vitit 2023 dhe kjo fillon në vitin 2025, që në koperinë dallon, por bazohem në atë që e tha kolegu z.Bashkim Sylja që edhe kjo strategji është vazhdimësi e strategjive tjera, nuk kam qëllim të kritikoj e thash në fillim uroj që kjo strategji të realizohet, për mua kjo është një fontanë dëshirash por besoj se do të ketë përpjekje maksimale për të arritur më shumë. Është një dokument që qytetari do ta ketë në dorë dhe ne do e shohim se si do të realizohet kjo strategji. Një detaj më ka ikur andaj për këtë arsye e mora fjalën vërtetë për hartimin e kësaj strategjie është kontraktuar një organizatë sepse sipas fjalimit të z.Haki Rudari është nënkuptuar se ky dokument është hartuar nga drejtorja e DPZHE-së, këtu ka qenë një organizatë profesionale që merret me hartimin e strategjive dhe kam bindjen se po të ishte hartuar një strategji me akter të Kuvendit do të ishte krejt ndryshe se do ishte më konkrete dhe më e mishëruar me problemet jetike të cilat i ka komuna jonë. Këto strategji që janë hartuar deri më tani janë të ilustruara mirë në fotografi, janë hartuar prej ekipeve që e kanë këtë profesion mirëpo shumë prej projekteve të kësaj strategjie nuk e kanë të cekur koston financiare, kostoja financiare e kësaj strategjie del të jetë më shumë se 47,000,000.00€, por ka projekte që kushtojnë me dhjetëra milionë euro mirëpo nuk e kanë të cekur koston financiare po e përmbylli fjalën me një fakt që për mua është shqetësues se tani t'i them kolegut z.Haki Rudari vetëm fjalë të mira pa ndonjë kritikë se di qysh ndihet por dua të them se njëri prej problemeve jetike qoftë të organizatave ndërkombëtare qoftë të atyre që jetojnë nën lëkurën tonë në Podujevë është gjendja e rëndë e mjedisit dhe në këtë gjendje kaq të rënduar e në veçanti me ujërat e zeza dhe mos të parashihet asgjë për trajtimin e ujërave të zeza, ndotjen e lumenjve, ku janë të parapara ndërtimet e mureve për lumenj por për trajtimin e ujërave të zeza nuk është paraparë ndërtimi i ndonjë kolektori apo impianti. Komuna e Podujevës ka hyrë në obligime financiare e kjo është votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me një bankë austriake dhe qytetarëve të Komunës së Podujevës së shpejti do ju vjen fatura për një projekt që është bërë dhe qytetarët do të fillojnë të paguajnë taksë a për atë projekt për një periudhë kohore 5 vjeçare dhe tani po kalojnë 5 vite dhe ai impiant i ujërave të zeza nuk është në funksion dhe qytetari do të fillojë të paguaj taksë për diçka që se shfrytëzon dhe e di se ka pas vërejtje dhe vitin e kaluar është ndaluar ai projekt dhe ato mjete janë kthyer si mjete të pa shpenzuara. Kam dëgjuar zëra që ndërtimi i këtij kolektori është i shtrenjtë nuk mund ta ndaj mendimin se e kanë mirë arsyeja pse të gjithë ata që mendojnë që kanë bërë mëkate dhe ka keqpërdorime institucioni është ai që duhet t'i identifikoj ata që kanë bërë defekte dhe janë organet të cilat merren me ta çfarë do emri qoftë ai, apo i cilit do subjekt politik qoftë ai, mirëpo qytetari i Komunës së Podujevës nuk e ka për borxh me mbajt në kurrizin e tij një ndotje të ambientit këso fare. Unë jam pak më i zëshëm në këtë drejtim sepse gjithçka po fillon prej personales, unë jetoj buzë lumit Dumnica dhe jetoj në atë fshat ku bashkohen lumenjtë Dumnica dhe Batllava me lumin Llap dhe me të vërtetë gjendja e lumenjve është

e degraduar në atë masë që po të kishte ndonjë gjykatë për degradim të lumenjve ndoshta ne do e zinim vendin e parë e mos të parashihet asgjë në strategjinë zhvillimore deri në vitin 2025 për trajtimin e lumenjve është më shumë se defekt.

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, DPZHE, theksoi, ju falënderoj për kontributin dhe interesimin rreth këtij dokumenti i cili është i vlefshëm për Komunën e Podujevës, unë jam i hapur që t'i marr gjitha sugjerimet dhe plotësime ndryshimet nga ana e juaj si nga ana e kolegëve z.Naim Çunaku dhe z.Bashkim Syla, që ta hartojmë një dokument sa më të mirë i cili na shërben gjatë 3 viteve të ardhme. Pas përfundimit të mbledhjes ne mund të diskutojmë rreth plotësimeve ndryshimeve të këtij dokumenti.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues drejtori e bëri një ofertë publike e jani e kontribuoni por pasi që e kemi seancën nesër ne do i bëjmë propozimet dhe nëse Kuvendi i sheh të arsyeshme propozimet tona i voton dhe ato automatikisht bëhen pjesë e strategjisë.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, pa humbur kohë më shumë tani e vë në votim Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit/KPF-së konstatoi se nga 9 anëtar sa ishin prezent në mbledhje, me 5 vota Për asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

3. Propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, dihet se Komuna e Podujevës paraprakisht ka pas një marrëveshje me bashkësinë islame në Podujevë për kompensimin e shpenzimeve të varrimit e për këtë pikë të rendit të ditës për sqarime konkrete fjalën ia kalojmë z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së buxhetit dhe financave-DBF-së.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, asambleja komunale në të kaluarën ka marrë një vendim për subvencionimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe tani para asamblesë komunale ka ardhë ky propozim, shpenzimet e kalkuluar janë 200€ për person të vdekur, subvencione këto për bashkësinë islame në Podujevë e cila kujdeset pastaj për ceremonitë tjera të varrimit për personat e vdekur.

z.Naim Çunaku, theksoi, rreth vazhimit të marrëveshjes mes bashkësisë islame në Podujevë dhe Komunës së Podujevës për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për personat e vdekur në Komunën e Podujevës këtë propozim e kemi mbështetur gjithëherë dhe e mbështesim edhe tani.

Kam një propozim shtesë, të gjithë ne këtu jem dëshmitar që secili nga ne ka familjarë që kanë ndërruar jetë dhe si problem shqetësues që e shoh unë është hapja e varreve, familjet tani jetojnë më të ndara dhe janë varfëruar dhe është problematikë kur dikush ka brenda rrethit familjar këtë barrë që duhet të kujdeset për këtë shërbim dhe duke e pas parasysh si nevojë që hapja e varrit për personin e vdekur nga ana e familjarëve është një problem andaj kisha dashur që ky propozimi im t'i shtohet kësaj marrëveshje që bashkësia islame të jetë e obliguar për hapjen e varrit për personat e vdekur në territorin e Komunës së Podujevës. Ne të gjithë jemi dëshmitarë për këtë se është problematikë të gjesh njerëz në një konfiguracion të fortë për të hapur varre për personat e vdekur prandaj duhet të angazhosh eskavator dhe individualisht çdo fshat ta bëjë këtë zgjedhje kishte me qenë më e kushtueshme ndërsa bashkësisë islame nuk do i kushtonte asgjë që të pajiset me dy eskavator dhe ta kryej këtë shërbim në tërë territorin e Llapit. Këtë e konsideroj si ndihmesë të madhe për gjithë ata njerëz që atë ditë kanë me i përcjellë më të dashurit

e tyre në botën e përjetshme prandaj propozimi im shtesë është që të shqyrtohet mundësia e hapjes së varreve nga ana e bashkësisë islame për personat e vdekur në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, unë personalisht kam biseduar disa herë me përfaqësuesit e bashkësisë islame në Podujevë për këtë temë por edhe ata e kanë këtë problematikë dhe janë deklaruar se nuk kanë të kontraktuar ndonjë kompani për kryerjen e këtij shërbimi. Të gjithë ne e dimë se deri më tani te na ka qenë traditë që varet të hapen me lopata ose me eskavatorë të vegjël mirëpo tani siç e ceku z.Naim Çunaku ndoshta kish qenë mirë që edhe këtë pjesë të këtij shërbimi ta merre përsipër bashkësia islame në Podujevë, mirëpo nga ana e tyre kemi një arsytim se në lokalitete të ndryshme të Podujevës ka raste që në të njëjtën ditë kemi 2 ose 3 raste të personave që kanë ndërruar jetë dhe nuk kanë mundësi që në të njëjtën kohë t'i kryejnë këto shërbime, mirëpo ndoshta do të ishte më mirë që të bisedojmë edhe njëherë me bashkësinë islame në Podujevë dhe të bëjmë një zgjidhje më të mirë, për këtë mund të na japë sqarime më shumë drejtori i DBF-së z. Fatlum Osmani.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, bashkësia islame në Podujevë kur e ka paraqitë kërkesën për subvencionim e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës aty i ka parapa edhe disa shpenzime për të cilat ka kërkuar që të subvencionohen. Në kërkesën e tyre nuk është kjo pjesa e hapjes së varreve për personat e vdekur nga ana e bashkësisë islame, ka të drejtë z.Naim Çunaku rastet të cilat i ceku se me të drejtë posaçërisht rastet të cilat janë në një periudhë shumë të shkurt, ta zëmë kemi rast vdekje në ora 10:00 dhe ceremonia e varrimit duhet të bëhet në procedurë të shpejtë me të vërtetë ky rast është shqetësues. Unë këtë çështje do e marrë si obligim të bisedoj me përfaqësuesit e bashkësisë islame sepse ne mund të votojmë këtë propozim dhe të kaloj por bashkësia islame pastaj mund që mos ta kryej këtë shërbim e kjo ka një arsye ashtu siç e ceku edhe Kryesuesi për shkak se komuna e Podujevës ka një territor mjaftë të gjerë dhe ta marrim shembull se në ditë 2 persona ndërrojnë jetë në Komunën e Podujevës këtë e them në bazë të pagesave që bëhen e që vërtetohen në bazë të certifikatave të vdekjes ku numri i rasteve të tilla brenda një muaji në komunën tonë arrin 50-60 persona. Ta marrim këtë në mënyrë hipotetike që kemi dy raste të vdekjes në dy lokalitete të ndryshme që janë larg njëri tjetrit në Komunën e Podujevës nuk e di teknikisht qysh do realizohej ceremonia e varrimit nga ana e bashkësisë islame në këtë rast, përndryshe do të ishte shumë mirë nëse kryhet ky shërbim nga ana e bashkësisë islame.

z.Naim Çunaku, theksoi, e di që kjo është një temë e ndjeshme mirëpo bashkësia islame e ka më lehtë ta realizojë këtë marrëveshje siç është, unë e kuptoj se po të ketë angazhim më të madh në këtë rast po të kenë makineri për hapjen e varreve do të ishte një obligim shtesë për bashkësinë islame dhe ky obligim shtesë mund t'i shqetësoj për arsye se a mund ta kryejnë këtë shërbim ose jo, për të dalë nga kjo situatë ndoshta do ishte më mirë që ky shërbim të përcaktohet në listën e çmimeve dhe të dihet përafërsisht se sa kushton kostoja e hapjes së një varri, përndryshe bashkësia islame me dëshirë ofrimin e këtij shërbimi nuk do e bën mirëpo kur e marrin para sysh pjesën tjetër besoj se do bëhen më solidar sepse ekziston mundësia që eskavatorët e vegjël brenda një ore mund t'i dërgosh në secilin lokalitet të Podujevës andaj besoj se me dy eskavator që kanë kosto prej 10,000.00€ mund të kryhet ky shërbim.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, a mund ta bëjmë një dakordim së bashku këtu kur jemi duke biseduar se mendimi po e nxjerr mendimin dhe problemi po e nxjerr problemin, tash kjo marrëveshje që do të votohet nesër prej muajit janar 2023 duhet të hyj në fuqi se pa këtë marrëveshje ne pastaj nuk mund t'i procedojmë pagesat, në momentin që ne në këtë marrëveshje e fusim edhe çështjen e hapjes së varrezave për personat e vdekur në Komunën e Podujevës, bashkësia islame pa tjetër duhet ta ofrojë këtë shërbim në mënyrë që ne t'ia procedojmë pagesat se pastaj ne na u paraqiten probleme në ekzekutimin e pagesave në qoftë se bashkësia islame nuk i përfundon gjitha shërbimet e saj të kontraktuar. Kemi edhe 20 ditë deri në përfundim të këtij viti dhe nuk e di se sa mund të jetë e gatshme bashkësia islame që brenda kësaj periudhe kohore të pajiset me njerëz, pajisje dhe logjistikë

që nevojitet për kryerjen e këtij shërbimi. Mendimi im është që ne të shkojmë në votim në bazë të kësaj marrëveshje, në bazë të propozimit të bashkësisë islame për shërbimet që i kryen ajo dhe pastaj të bisedojmë gjatë kësaj periudhe me përfaqësuesit e bashkësisë islame në mënyrë që në mbledhjet e radhës ta votojmë një aneks kontratë e pastaj të hyjë në fuqi nga muaji mars ose prill dhe t'i njoftojmë që t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme në mënyrë që ta kryejnë edhe këtë shërbim se për ndryshe mund të na shfaqen probleme sepse bashkësia islame nuk mund ta kryej shërbimin pastaj ne nuk mund të bëjmë ekzekutimin e pagesave për një shërbim i cili nuk është përfunduar.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk desha që propozimi im të kuptohet në atë mënyrë që unë po i kushtëzoi për kontratën e dytë për hapjen e varreve për personat e vdekur në Komunën e Podujevës, mirëpo tani t'i shikojmë mundësit për kryerjen e këtij shërbimi në një të ardhme sa më të shpejtë se është një shqetësim i qytetarëve.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, absolutisht ky shërbim është i nevojshëm dhe nëse bashkësia islame e krijon logjistikën e saj atëherë nuk mund të ketë ndonjë diferencë të madhe në kosto.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, në qoftë se bashkësia islame e merr përsipër kryerjen e këtij shërbimi ta zëmë se do të hapen 30 varre brenda një muaji atëherë kostoja e tyre do të jetë 1,500.00€, që nënkupton se duhet të jetë një punëtor i rregull me eskavator.

z.Naim Çunaku, theksoi, më duhet ta them edhe një fjali edhe pse po bëhem i tepërt sepse bashkësia islame edhe dërrasat i kontraktin dikund prandaj bashkësia islame mund të kontrakttoj kompani për hapjen e varreve për personat e vdekur në Komunën e Podujevës.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, besoj se kostoja për hapjen e një varri duhet të jetë 50€.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, nuk mund të themi sigurt se kostoja për hapjen e një varri mund të jetë 50€, këtu është problemi.

z.Naim Çunaku, theksoi, kostoja për hapjen e një varri mund të jetë 100€, por ne familjarëve duhet t'i gjendemi pranë në momentet më të vështira sepse sot mund të jenë qytetarët në këtë pozitë por mos të harrojmë se në pozitën e tyre nesër mund të jemi ne.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, nëse kostoja për hapjen e një varri kushton 100€ atëherë kostoja do të rritet për 300€.

z.Haki rudari, theksoi, realisht ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës sepse shumë qytetarë janë në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale. Propozimin e z.Naim Çunaku përsipër e mori drejtori që të bisedoj me përfaqësuesit e bashkësisë islame dhe të inkorporohet ai propozim në marrëveshje, natyrisht pastaj do të ndryshoj edhe çmimet e subvencionimit në rast se bashkësia islame e merr përsipër ofrimin e shërbimit për hapjen e varreve për personat e vdekur në komunën tonë por si do që të jetë nëse ata kanë një mendim pozitiv drejtori na informon dhe në të ardhmen mund ta inkorporojmë në këtë vendim.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë pa humbur kohë më shumë e vë në votim Propozim vendimin për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit/KPF-së konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të këtij propozim vendimi.

4. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

znj.Saranda Stublla, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, theksoi, si pikë të rendit të ditës listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023, ne ua kemi sjellë nga një kopje të re për arsye se ndërkohë e kemi bërë vlerësimin dhe destinimin e pronave ashtu siç parashihet me hartën zonale prandaj ju ftoj ta votoni këtë pikë të rendit të ditës.

z.Qendrim Softolli, theksoi, dua të ndërlidhem me këtë pikë të rendit të ditës, kuptohet ne si grup në parim e përkrahim këtë sepse dhënia në shfrytëzim e pronave të pa luajtshme është në interes të komunës por si zotim kemi marrë nga ana e ekzekutivit sjelljen e listës së gjitha pronave komunale, ka qenë afati i muajit mars kurse tani jemi në muajin dhjetor dhe ende nuk e kemi pranuar listën e gjitha pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023, të them listën e përgjithshme.

znj.Saranda Stublla, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, theksoi, është duke u përgatitur lista e përgjithshme pronave në Komunën e Podujevës dhe së shpejti besoj se do të publikohet në ueb faqen e komunës, kemi pas shumë punë rreth kësaj liste dhe thujse kjo listë tani është në finalizim.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e vë në votim propozim vendimin për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023 me ndryshimet që ka ardhë në mbledhjen e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit/KPF-së konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të këtij propozim vendimi, përfshirë Listën e harmonizuar sa i përket destinimit të pronave konform Hartës Zonale, Listë e cila u paraqit nga Drejtoresha e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (bashkëngjitur)

5. Rishqyrtimi i Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba Komunal

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës besoj se debati rreth saj përfundoj më parë andaj e vë në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit/KPF-së konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit për përfshirje në kandër të rendit të ditës dhe rishqyrtim, përkatësisht për anulimin e të njëjtës me rekomandim që nga Ekzekutivi i Komunës të fillohet me përgatitjen e draftit të ri sipas vlerësimeve të Ministrive dhe konsultimeve paraprake.

6. Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës.

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, theksoi, ashtu siç ju njoftova edhe më parë edhe kjo pikë e rendit të ditës duhet të kaloj në Kuvend për rishqyrtim prandaj pa humbur kohë më shumë e vë në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit/KPF-së konstatoi se njëzëri me 6 vota Për, 3 vota të përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për përfshirje në kandër të rendit të ditës dhe rishqyrtim të aktit në fjalë (bashkëngjitur vlerësimet e Ministrisë)

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

**Procesverbalin e mbajti
Osman Bajrami**

**Nr.prot.01-060/04-0100798/22
Podujevë,
08 dhjetor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**